

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2025

KUALIFIKIMI PROFESIONAL "SIGURIME"

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30		
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Themi se kemi të bëjmë me kërkesë për një mall vetëm atëherë kur: **1 pikë**
- A) Kemi nevojë për këtë mall;
 - B) Dëshirojmë ta kemi këtë mall;
 - C) Jemi të aftë të paguajmë për ta blerë këtë mall;
 - D) Çmimi i këtij malli ulet në treg;
2. Një firmë në një periudhë afatshkurtër prodhon bluza. Kostoja totale fikse e saj (TFC) është 500 lekë dhe kostoja totale variabël ((TVC) është 1000 lekë .Atëherë kostoja totale e kësaj firme do të jetë: **1 pikë**
- A) 750 lekë;
 - B) 1000 lekë;
 - C) 1250 lekë;
 - D) 1500 lekë;
3. Kur flasim për kategoritë “Kërkesë” dhe “Nevojë”, kemi parasysh se që të dyja : **1 pikë**
- A) Janë kategori të njëjta;
 - B) Janë kategori të ndryshme;
 - C) Nuk iu interesojnë konsumatorëve;
 - D) Grafikisht lakoret e tyre priten me njëra tjetrën;
4. Cilën nga funksionet e mëposhtme kryen Banka e Shqipërisë : **1 pikë**
- A) Pranon depozita nga individët;
 - B) Jep hua për klientët;
 - C) Emeton monedhën vendase;
 - D) Pagan interesa për depozitat e individëve;
5. Për të gjithë mjetet motorike me targa shqiptare që qarkullojnë jashtë territorit shqiptar, sigurimi motorik quhet: **1 pikë**
- A) Kartoni jeshil;
 - B) Sigurimi TPL;
 - C) Sigurimi Kasko;
 - D) Sigurimi KUFITAR;
6. Marrja e një kredie konsiderohet risk: **1 pikë**
- A) Personal;
 - B) Spekulativ;
 - C) I pastër;
 - D) Financiar;
7. Është risk financiar: **1 pikë**
- A) Bllokimi në trafik;
 - B) Rrëzimi i avionit;
 - C) Zgjedhja e bashkëshortit;
 - D) Ndryshimi i vendbanimit;

8. Kontratat e sigurimeve kanë disa karakteristika. Cila nga alternativat e mëposhtme **NUK** është karakteristikë tipike e tyre: **1 pikë**
- A) Të kushtëzuara;
 - B) Të njëanëshme;
 - C) Të transferueshme;
 - D) Të dëmshpërblimeve;
9. Duke u nisur nga statistikat dhe probabiliteti i ndodhjes së ngjarjeve që prodhojnë dëm financiar primi që llogarisin aktuarët quhet: **1 pikë**
- A) Primi neto;
 - B) Primi bruto;
 - C) Primi i pastër;
 - D) Primi kontraktual;
10. Cila nga alternativat e mëposhtme **NUK** është kriter në përcaktimin e primit të sigurimit kufitar: **1 pikë**
- A) Ngjyra e mjetit;
 - B) Fuqia motorike e mjetit;
 - C) Viti i prodhimit të mjetit;
 - D) Numri i vendeve të mjetit;
11. Kontributet për sigurimet shoqërore: **1 pikë**
- A) Paguhen vetëm nga punëmarrësi.
 - B) Paguhen vetëm nga punëdhënësi.
 - C) Paguhen nga punëmarrësi dhe punëdhënësi;
 - D) Llogariten në bazë të pagës vjetore;
12. Nëse vlera e dëmit (D) është 45.000 euro, shuma e siguruar (Shs) është 60.000 euro dhe vlera e mallrave të ekspozuara ndaj zjarrit (Vrm) është 90.000 euro, atëherë masa e dëmshpërblimit (Md) do të jetë: **1 pikë**
- A) 25.000 euro;
 - B) 30.000 euro;
 - C) 45.000 euro;
 - D) 60.000 euro;
13. Cila nga alternativat e mëposhtme tregon formën në të cilën mund të merret dëmshpërblimi: **1 pikë**
- A) Me para në dorë, rinovimi, riparimi, zëvendësimi;
 - B) Me para në dorë, riparimi, zëvendësimi; rikthimi;
 - C) Me para në dorë, rinovimi, ndryshimi, zëvendësimi;
 - D) Me para në dorë, rinovimi, riparimi, rikthimi;

14. Përfshirja në skemën e sigurimeve shoqërore jo vetëm të pensionit, por edhe të sëmundjeve, barrë-lindjeve, papunësisë, etj., është shprehje e parimit të: **1 pikë**
- A) Universalitetit;
 - B) Mjaftueshmërisë;
 - C) Kompleksitetit;
 - D) Uniformitetit dhe barazisë;
15. Në praktikën e sigurimeve për sa i përket llogaritjes së primit neto, cila nga alternativat është e duhura: **1 pikë**
- A) Primi Neto = primi i pastër + shtesat;
 - B) Primi Neto = primi i pastër – shtesat;
 - C) Primi Neto = primi i pastër / shtesat;
 - D) Primi Neto = primi i pastër * shtesat;
16. Cila nga alternativat e mëposhtme është veçori e veprimtarisë tregtare të një siguruesi: **1 pikë**
- A) Produktet blihen dhe shiten me interes;
 - B) Kompanitë e sigurimeve “ shesin premtime”;
 - C) Në kompanitë e sigurimeve ka tjetërsim të objektit të siguruar;
 - D) Në kompanitë e sigurime vlerësimi i dëmit bëhet lehtësisht;
17. Risku që shkaktohet nga një ngjarje, prej të cilës individi pret vetëm një rezultat të mundshëm – humbjen, është risku i pastër. Ky risk konsiderohet si risk financiar: **1 pikë**
- A) Me raste;
 - B) Asnjëherë;
 - C) Shpeshherë;
 - D) Gjithmonë;
18. Çmimi i produkteve të sigurimit është: **1 pikë**
- A) Interes;
 - B) Fitim;
 - C) E ardhur;
 - D) Shpenzim;
19. Paga bruto e një punonjësi është 70.000 lekë. Detyrimet e punëdhënësit për kontributin e detyruar të sigurimeve shoqërore janë : **1 pikë**
- A) 1.190 lekë;
 - B) 6.650 lekë;
 - C) 7.840 lekë;
 - D) 10.500 lekë;

20. Punëmarrësi sipas ligjit në fuqi të vitit 2014 kur të ardhurat mujore bruto nga marrëdhëniet e punësimit janë më të mëdha se paga referuese paguan kontribut për sigurimet shoqërore: **1 pikë**

- A) 9.5% të pagës bruto;
- B) 9.5% të pagës referuese;
- C) 15% të pagës bruto;
- D) 15% të pagës referuese;

21. Në secilin nga pohimet e mëposhtme, rretho përgjigjen e saktë. **4 pikë**

- A) Tregu quhet në ekuilibër kur sasia e kërkuar është e barabartë me sasinë e ofruar për të njëjtin çmim.
PO JO
- B) Çmimi në të cilin sasia e kërkuar është e barabartë me sasinë e ofruar quhet çmim ekuilibër
PO JO
- C) Në qoftë se sasia e ofruar do të jetë më e vogël se sasia e kërkuar do të kemi tepriçë oferte.
PO JO
- D) Në qoftë se sasia e ofruar do të jetë më e madhe se sasia e kërkuar, do të kemi mungesë oferte.
PO JO

22. Për secilin nga konceptet e mëposhtme tregoni çfarë është: **4 pikë**

A) Papunësia friksionale

B) Papunësia strukturore

C) Papunësia ciklike

D) Papunësia sezonale

23. Llojet e pensioneve që mund të përfitojnë personat të cilat kanë paguar kontributet në shtetin shqiptar janë disa. Renditni më poshtë katër prej tyre: **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

24. Evidentoni katër kushtet që duhen plotësuar për të marrë përfitimet financiare të sigurimit shoqëror.

4 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

25. Në lidhje me pohimet e mëposhtme, rrethoni përgjigjen e saktë:

4 pikë

- A) Me dëm pasuror kuptohet dëmi i ardhur si pasojë e cënimit të një të drejte, e cila përfaqësohet nga një vlerë tregu, gjithmonë e vlerësueshme në të holla.
PO JO
- B) Dëmi material nuk ekziston kur individit i shkaktohen lëndime trupore ose cënim të shëndetit.
PO JO
- C) Shpërblimi i dëmit material për shkak të dëmtimit të pasurisë përfshin vlerën apo interesin pasuror që e ka humbur i dëmtuari
PO JO.
- D) Objekti i sigurimeve është që të rikthejë të siguarin pas pësimit të një humbjeje, në të njëjtën gjendje financiare që ai kishte përpara humbjes.
PO JO

26. Pjesët kryesore të një kontrate sigurimi janë disa. Renditni më poshtë katër prej tyre:

4 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

27. Për secilin nga konceptet e mëposhtme tregoni çfarë është :

4 pikë

A) Dëmi

B) Dëmshpërblimi

C) Primi

D) Kontrata e sigurimit

28. Në bazë të listëpagesës së muajit prill 2023 për shoqërinë e sigurimeve "Sigma", në lidhje me një punonjës kemi këto të dhëna: Paga bazë është 80.000 lekë; shtesa mbi pagën për vjetërsi në punë është 5.500 lekë; shtesa mbi pagën për orë jashtë orarit është 4.500 lekë. **4 pikë**

Kërkohe:

- 1) Të llogaritet paga bruto për punonjësin.
- 2) Të llogariten sigurimet shoqërore që paguan punonjësi për muajin Prill
- 3) Të llogariten sigurimet shëndetësore që paguan punonjësi për muajin Prill
- 4) Të llogaritet paga neto, kur ndalesa për TAP është 7.800 lekë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

29. Shoqëria "Sigal" për vitin muajin Mars 2023 ka kryen këto veprime:

4 pikë

- Në dt 15.03.2023 ka shitur polica sigurimi me vlerën 1.000.000 lekë
- Në dt 20.03.2023 ka arkëtuar nga shitja e këtyre policave në bankë shumën 160.000 lekë
- Në dt 22.03.2023 ka blerë nga një furnitor një autoveturë me vlerën 10.000.000 lekë
- Në dt 30.03.2023 ka bërë likuidimin e pagave me bankë me vlerë 370.000 lekë

Kërkohe:

- 1) Të regjistrohet në ditar shitja e policës së sigurimit
- 2) Të regjistrohet në ditar arkëtimi i vlerës për shitjen e policës
- 3) Të regjistrohet në ditar blerja e autoveturës
- 4) Të regjistrohet në ditar likuidimi i pagave

Ditari i përgjithshëm

Data	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi

30. Shoqëria "Eurosig" për vitin 2022 kryen këto shërbime financiare:

4 pikë

- Në datë 01.03.2022 shiten polica TPL sipas kontratës me afat 1 vjeçar me vlerë 1.500.000 lekë.
- Në datë 01.03.2022 arkëtohet 80 % e shumës së shitur.
- Në datë 20.03.2022 shoqëria risiguron 10 polica me shumën 300.000 lekë te shoqëria Elsig
- Në datë 25.03.2022 shoqëria paguan me bankë 80 % të shumës se risiguar.

Kërkohe :

- 1) Të regjistrohet në ditar shitja e policave TPL
- 2) Të regjistrohet në ditar arkëtimi i vlerës për shitjen e policave
- 3) Të regjistrohet në ditar risigurimi i policave
- 4) Të regjistrohet në ditar pagesa për shumën e risiguar

Ditari i përgjithshëm

Data	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi